

Bashkëpunimi ndërkombëtar i AKSP

Akademia e Kosovës për Siguri Publike është anëtare e asocioneve të ndryshme evropiane dhe ndërkombëtare të trajnimit dhe arsimit në siguri publike dhe zbatimin e ligjit:



Anëtare vëzhguese e Asociacionit të Kolegjeve Policore Evropiane - AKPE (AEPC) <https://www.aepc.net/>



INTERPA
INTERNATIONAL ASSOCIATION
OF POLICE ACADEMIES

Anëtare e plotë e Asociacionit Ndërkombëtar të Akademive Policore (INTERPA) <http://www.interpa.org/>



Drejtori i Përgjithshëm është anëtar i Asociacionit Ndërkombëtar të Drejtorëve të Standardeve dhe Trajnimit të Zbatimit të Ligjit - ANDSTZL (IADLEST) <https://www.iadlest.org/>

Për më tepër, AKSP ka katër Marrëveshje Bashkëpunimi me:



Kolegjin Universitar Policor të Finlandës <http://www.polamk.fi/>



Akademine e Estonisë të Shkencave të Sigurisë <http://www.sisekaitse.ee/>.



Akademine e Sigurisë së Shqipërisë <http://www.asp.gov.al/>.



Marrëveshje tripalëshe me Institutin e Trajnimit të Shërbimeve të Burgut dhe Sprovues <http://www.rskk.fi/fi> dhe Universitetin Laurea të Shkencave të Aplikuara <https://www.laurea.fi/>.



Organizuar nga ICITAP dhe me mësimdhënie nga Universiteti North-Western nga Shtetet e Bashkuara, për të katërtën herë në AKSP është mbajtur Shkolla Vjetore e Stafit dhe Komandës Policore, që i dedikohet zyrtarëve të nivelit të lartë menaxhues të institucioneve të zbatimit të ligjit. Përveç vendorëve, pjesëmarrësit vijnë nga Shqipëria, Bosnjë dhe Hercegovina, Kroacia, Mali i Zi dhe Maqedonia.

AKSP është aktive edhe në bashkëpunimin regjional. Ajo ka bashkëpunim dypalësh dhe shumëpalësh me shumë institucione të ngjashme të Evropës Jug-Lindore. Nga 22 - 25 shtator 2013, në Prishtinë është bashkë-organizuar nga AKSP-ja e Policia e Kosovës dhe përkrahur nga Misioni në Kosovë i OSBE-së Konferenca e Tretë e Trajnimit Policor e Vendeve të Ballkanit (BALPEK III) me pjesëmarrës nga Shqipëria, Hungaria, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Turqia.

Për shkak të së kaluarës së AKSP-së si institucion trajnues dhe arsimues për institucionet e sigurisë publike të një vendi të pasluftës, në mënyrë që të ndajë përvojat dhe praktikat më të mira të saj, është treguar interes i shoqërive të pas konflikteve për bashkëpunim me të. Prandaj, AKSP së fundmi është vizituar nga delegacione të ndryshme nga Libia, Iraku dhe Afganistani.

AKSP ka bashkëpunim të mirë edhe me organizatat dhe institucionet ndërkombëtare në Kosovë, siç janë: Misioni në Kosovë i OSBE-së, ICITAP, Zyra e BE-së në Kosovë, Këshilli i Evropës, KFOR, EULEX, UNICEF, si dhe me ambasadat të shteteve të ndryshme në Kosovë si në vijim: Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Mbretëria e Bashkuar, Gjermania, Franca, Belgjika, Austria, Finlanda, Hungaria, Turqia, Shqipëria etj.

Perspektiva

Për më tepër, Akademia ka për qëllim të forcojë dhe më tutje bashkëpunimin ndërkombëtar. Tashmë është inicuar bashkëpunimi me Kolegjin Policor Evropian (CEPOL) dhe Qendrën e Gjenevës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF).

